


B. Rojomi



BASHKIA KURBIN



**Plani Arsimit Parauniversitar
2026 - 2028**

Përmbajtja

1. Hyrje dhe konteksti.....	5
Konteksti administrativ	5
Të dhëna demografike.....	6
Kadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor	7
2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025.....	8
Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor.....	8
Përfshirja e fëmijëve 3–6 vjeç në arsimin parashkollor në Bashkinë Kurbin	9
3. Analiza e shërbimit të arsimit 9-vjeçar dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025	10
Analiza e nevojave për rikonstruksion në institucionet arsimore	11
Frekuentimi në Arsimin fillor	11
Frekuentimi në Arsimin 9-vjeçar	11
Frekuentimi në Arsimin e mesëm	12
4. Shpërndarja e institucioneve arsimore në njësitë administrative të Bashkisë Kurbin.....	12
Njësia Administrative: Laç.....	12
Njësia Administrative: Mamurras	12
Njësia Administrative: Milot.....	13
Njësia Administrative: Fushë-Kuqe	14
5. Analiza edhe shpërndarja e stafit arsimor në territorin e bashkisë	15
6. Vizioni, qëllimet strategjike, objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar	16
Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve	17
7. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar	18
8. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)	20
9. Plani i investimeve kapitale.....	32
10. Monitorimi dhe vlerësimi	33
11. Rishikimi dhe përshtatja e planit.....	34
12. Raportimi dhe transparenca	35
13. Aneks 1: Kadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar	36

Parathënie

Bashkia Kurbin ka ndërmarrë një proces gjithëpërfshirës për hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar, si një dokument udhëzues shumëvjeçar që synon të përmirësojë ndjeshëm cilësinë, aksesin dhe barazinë në shërbimet arsimore në të gjithë territorin e saj. Ky plan është ndërtuar mbi analiza të thelluara të situatës aktuale, të dhëna të detajuara për shkollat dhe kopshtet, si dhe mbi konsultime me aktorët lokalë e komunitetin, për të reflektuar realisht sfidat dhe mundësitë që karakterizojnë zonat urbane dhe rurale të Kurbin.

Në një bashki me diversitet gjeografik dhe shtrirje nga bregdeti i Patokut deri në zonat kodrinore të Mamurrasit dhe Milotit, ofrimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, të sigurt dhe cilësor është një sfidë dhe një domosdoshmëri. Ky dokument parashtron objektiva të qarta dhe ndërhyrje konkrete për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe parashkollore, zhvillimin profesional të stafit arsimor, zgjerimin e shërbimeve mbështetëse, si dhe forcimin e lidhjes mes shkollës, familjes dhe komunitetit.

Në thelb të këtij vizioni qëndron angazhimi i Bashkisë Kurbin për të ndërtuar një sistem arsimor që u garanton të gjithë fëmijëve dhe të rinjve të territorit mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u zhvilluar dhe për të ndërtuar të ardhmen e tyre në një mjedis të sigurt dhe mbështetës. Ky plan është një instrument i rëndësishëm politikash vendore dhe një shembull i konkretizimit të parimit të barazisë në aksesin ndaj arsimit, në përputhje me standardet kombëtare dhe synimet zhvillimore të qëndrueshme.

Bashkia Kurbin do të vijojë të angazhohet për zbatimin me përkushtim të këtij plani, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet arsimore, komunitetin, donatorët dhe çdo aktor që ka në qendër të punës së tij mirëqenien dhe edukimin e fëmijëve.

Majlinda Cara

Kryetare e Bashkisë Kurbin

Falënderime

Bashkia Kurbin shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Kurbinit, për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për angazhimin e strukturave të tij në sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.

Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioritetëve të komunitetit.

Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Kurbin..

1. Hyrje dhe konteksti

Konteksti administrativ

Bashkia Kurbin shtrihet në Shqipërinë Qendrore dhe përfshin një hapësirë prej 269.03 kilometrash katrorë. Ajo kufizohet në veri me bashkitë Lezhë dhe Mirditë, në lindje me bashkinë Mat, në jug me Krujën dhe Durrësin, ndërsa në perëndim ka dalje direkte në Detin Adriatik përgjatë vijës bregdetare të rezervatit natyror Patok–Fushë Kuqe. Kjo vendosje gjeografike i jep bashkisë një profil të larmishëm natyror, që ndërthur zona urbane, fushore, kodrinore dhe bregdetare me potencial të zhvilluar bujqësor, turistik dhe mjedisor.

Sipas Censusit të vitit 2023, në territorin e kësaj bashkie jetojnë 34,405 banorë. Këto të dhëna përforcojnë nevojën për planifikim të kujdesshëm të shërbimeve publike, përfshirë edhe ato të arsimit parauniversitar, për të përballuar kërkesën në rritje dhe ndryshimet demografike.

Bashkia përbëhet nga katër njësi administrative:

- Laç,
- Mamurras,
- Milot dhe
- Fushë-Kuqe,

të gjitha pjesë përbërëse të bashkisë Kurbin në qarkun Lezhë. Këto njësi përfaqësojnë një ndërthurje të zonave urbane dhe rurale, çka ndikon drejtpërdrejt në mënyrën e organizimit të shërbimeve publike dhe në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe financiare.

Pjesa më e madhe e territorit ka karakter bujqësor dhe është e përshtatshme për zhvillimin rural, përfshirë edhe kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike si: sherebela, trumza, kamomili, çaji i malit dhe mëllaga, që përmbajnë lëndë aktive dhe përdoren për qëllime fitosanitare apo komerciale. Zona e Patokut, me lagunën dhe rezervatin natyror, ka marrë zhvillim të konsiderueshëm si destinacion turistik ditor dhe zonë peshkimi, çka përforcon rolin ndërsektorial të arsimit për komunitetet lokale.

Kjo strukturë komplekse gjeografike dhe sociale kërkon një qasje të diferencuar dhe të ndjeshme në planifikimin dhe menaxhimin e shërbimeve të arsimit parauniversitar, me qëllim që të garantohet akses i barabartë, përfshirje sociale dhe cilësi e njëtrajtshme në të gjitha njësitë territoriale të Bashkisë Kurbin.

Të dhëna administrative	Vlerë
Sipërfaqja	269.03 km ²
Popullsia bashkisë	34,405 (Cens 2023)
Njësi administrative	Laç, Mamurras, Milot dhe Fushë-Kuqe


Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit demografike, popullsia totale e Bashkisë Kurbin është 34,405 banorë, me një shpërndarje të balancuar gjinore:

- 17,256 meshkuj (50.1%)
- 17,149 femra (49.9%)

Shpërndarja sipas njësive administrative është si më poshtë:

- **Laç:** 12,854 banorë – njësia më e madhe demografikisht
- **Mamurras:** 11,442 banorë
- **Milot:** 6,193 banorë
- **Fushë-Kuqe:** 3,916 banorë



Njësia administrative	Gjinia	Popullsia
Laç	Femer	6476
	Mashkull	6378
Mamurras	Femer	5638
	Mashkull	5804
Milot	Femer	3071
	Mashkull	3122
Fushë-Kuqe	Femer	1964
	Mashkull	1952

Laçi ka përqendrimin më të lartë të popullsisë në Bashkinë Kurbin, duke ndikuar drejtpërdrejt në nevojat për shërbime arsimore, ndërsa Fushë-Kuqe paraqet popullsi më të ulët, gjë që mund të kërkojë strategji të posaçme për garantimin e aksesit dhe përfshirjes në shërbimet e arsimit parauniversitar.

Njësia Administrative	3–6 vjeç (parashkollor)	6–15 vjeç (arsimi bazë)	15–18 vjeç (i mesëm)	Totali
Laç	2,430	2,655	1,007	6,092
Mamurras	446	1,524	705	2,675
Milot	405	952	502	1,859
Fushë-Kuqe	116	219	384	719
Totali	3,397	5,350	2,598	11,345

- **Grupmosha parashkollore (3–6 vjeç)** përbëhet nga 3,397 fëmijë, ku nevoja për shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirëse në edukimin e hershëm është evidente, veçanërisht në Laç.
- **Grupmosha 6–15 vjeç**, me 5,350 fëmijë, përfaqëson bazën më të gjerë të nxënësve në arsimin bazë, kërkon vëmendje për cilësinë e mësimdhënies dhe infrastrukturën shkollore.
- **Grupmosha 15–18 vjeç**, me 2,598 të rinj, nënvizon domosdoshmërinë për investime në arsimin e mesëm të lartë dhe orientimin profesional.

Laç ka numrin më të lartë të fëmijëve dhe të rinjve në çdo grupmoshë dhe përfaqëson mbi **53% të gjithë popullsisë në moshë shkollore** në bashki. **Fushë-Kuqë**, me vetëm **719 individë** në këto grupmosha, tregon për sfida në planifikimin dhe sigurimin e shërbimeve të decentralizuara.

Struktura demografike e popullsisë karakterizohet nga një përqindje domethënëse e fëmijëve në moshë parashkollore dhe e të rinjve, çka e bën zhvillimin e shërbimeve arsimore një përparësi të padiskutueshme në politikat vendore.

Kjo përbërje demografike reflekton nevojën për një planifikim të kujdesshëm dhe afatgjatë të burimeve arsimore në të gjitha nivelet, me theks të veçantë në edukimin e hershëm dhe arsimin e mesëm. Rritja e kapaciteteve infrastrukturore, përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe garantimi i aksesit të barabartë për çdo fëmijë dhe të ri përbëjnë elemente thelbësore për të përmbushur kërkesat e një popullsie të re.

<i>Njësia administrative</i>	<i>Gjina</i>	<i>Popullsia</i>
<i>Grup-mosha</i>		Popullsia
0-4 vjeç		1732
5-9 vjeç		1917
10-14 vjeç		2217
15-19 vjeç		2121

Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor

Zbatimi i funksioneve të Bashkisë Kurbin në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe politik, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike për garantimin e të drejtës për arsim.

Bazën më të lartë ligjore e përbën **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, ku në nenin 57, pika 1, sanksionohet e drejta për arsim për të gjithë qytetarët. Kjo e drejtë konkretizohet më tej përmes **Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”**, të ndryshuar me **Ligjin nr. 48/2018**, i cili përcakton strukturën dhe funksionimin e arsimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe profesional. Ky ligj rregullon gjithashtu standardet e cilësisë, përfshirjes, vlerësimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” u njeh bashkive kompetenca të plota për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike, si dhe role mbështetëse në arsimin bazë dhe të mesëm, përmes sigurimit të infrastrukturës, përfshirjes sociale dhe koordinimit me institucionet qendrore. Këto funksione financohen dhe mbështeten në përputhje me **Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**, dhe **Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”**, të cilët përcaktojnë rregullat e menaxhimit financiar në nivel vendor. Po ashtu, **Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”**, i ndryshuar, shërben si mjet për mobilizimin e të ardhurave që bashkia mund të përdorë për të mbështetur sektorin e arsimit.

Në nivel zbatimi, funksionimi i institucioneve arsimore rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore. Ndër më të rëndësishmet është **Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020**, që miraton rregulloren e përgjithshme për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, si dhe **Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023**, që përcakton normat për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore për mësuesit. Po ashtu, **udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, specifikon

organizimin e vitit shkollor 2024–2025, ndërsa Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018, përcakton ngritjen dhe funksionimin e bordeve të institucioneve arsimore, si mekanizma pjesëmarrjeje dhe monitorimi. Një dokument me rëndësi për cilësinë e arsimit parashkollor është edhe Urdhri nr. 199, datë 07.05.2024, që miraton Kornizën e vlerësimit të cilësisë së kopshteve.

Në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Bashkia Kurbin udhëhiqet gjithashtu nga Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, të cilët kërkojnë ndërhyrje të koordinuara për mbështetjen e fëmijëve në nevojë dhe parandalimin e përjashtimit social. Në këtë drejtim, udhëzime specifike si Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014, për rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët romë, dhe Plani Kombëtar i Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025, përbëjnë udhërrëfyes për politikën lokale në territorin e Bashkisë Kurbin.


Një fushë me rëndësi të veçantë është edhe ofrimi i shërbimit psiko-social në shkollë, i cili rregullohet me Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, si dhe me udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor, të hartuar për stafet e bashkive dhe të zyrave vendore arsimore. Gjithashtu, për të garantuar një ambient të sigurt dixhital për fëmijët, zbatohet Udhëzimi i përbashkët MAS-MShMS nr. 658, datë 23.09.2019, i cili përcakton masa për mbrojtjen e tyre nga përmbajtjet e dëmshme në internet.

Nëpërmjet këtij kuadri të gjerë ligjor dhe politik, Bashkia Kurbin vepron si një aktor kyç në zbatimin e politikave arsimore dhe sociale, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve në territorin e saj. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me Zyrën Vendore Arsimore dhe institucionet e tjera publike, synohet ndërtimi i një sistemi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë.

2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor

Në Bashkinë Kurbin shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Në Bashkinë Kurbin funksionojnë 21 kopshte të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e



kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.

<i>Emri i kopshtit</i>	<i>Njesia Administrative</i>
<i>Kopshti nr. 3 Laç</i>	Laç
<i>Kopshti nr. 2 Laç</i>	Laç
<i>Kopshti nr. 1 Laç</i>	Laç
<i>Gjokë Elezi</i>	Laç
<i>Demokracia</i>	Mamurras
<i>Adem Myrta</i>	Mamurras
<i>Ismail Dema</i>	Mamurras
<i>Dan Bajrami</i>	Mamurras
<i>Fran Pal Piroli</i>	Mamurras
<i>Mimozat</i>	Mamurras
<i>Kopshti nr. 2 Mamurras</i>	Mamurras
<i>Milot</i>	Milot
<i>28 Nëntori</i>	Milot
<i>Shullaz</i>	Milot
<i>Cub Çapani</i>	Milot
<i>Skurraj</i>	Milot
<i>Vinjollë</i>	Milot
<i>Nik Tom Prela</i>	Fushë-Kuqe
<i>Adriatik</i>	Fushë-Kuqe
<i>Nikoll Miri</i>	Fushë-Kuqe
<i>Fushë Kuqe</i>	Fushë-Kuqe

Përfshirja e fëmijëve 3–6 vjeç në arsimin parashkollor në Bashkinë Kurbin

Sipas të dhënave më të fundit, në Bashkinë Kurbin janë rezident gjithsej **1,196 fëmijë të moshës 3–6 vjeç**, prej të cilëve **628 janë djem** dhe **568 janë vajza**. Nga këta, **736 fëmijë** ndjekin institucionet e arsimit parashkollor (kopshtin), duke përfaqësuar një përfshirje totale prej **61.54%**.

Shkalla e përfshirjes ndryshon lehtësisht sipas gjinisë:

- **60.51% e djemve** ndjekin kopshtin (380 nga 628),
- **62.68% e vajzave** ndjekin kopshtin (356 nga 568).

Diferencat e lehta gjinore në përfshirje dhe niveli i përgjithshëm i pjesëmarrjes sugjerojnë se faktorë si infrastruktura, ndërgjegjësimi i familjeve, mundësitë ekonomike, apo faktorë si migracioni dhe memigracioni ndikojnë në qasjen e fëmijëve në institucionet parashkollore.

3. Analiza e shërbimit të arsimit 9-vjeçar dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025

Rrjeti i shkollave në territorin e Bashkisë Kurbin është organizuar në funksion të mbulimit të nevojave arsimore të komunitetit, duke pasur si qëllim sigurimin e aksesit të barabartë në arsim për çdo fëmijë, pavarësisht vendbanimit apo sfondit ekonomik. Institucionet arsimore klasifikohen sipas cikleve mësimore që ato mbulojnë:

- **Shkolla 9-vjeçare**

Këto shkolla ofrojnë arsimin bazë të plotë (cikli fillor + cikli i mesëm i ulët). Ato janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë pjesën më të madhe të territorit, duke përfshirë si zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Roli i tyre është kyç në garantimin e një edukimi të njëtrajtshëm për nxënësit dhe përgatitjen e tyre për fazën e ardhshme arsimore.

- **Shkolla të mesme**

Përfshijnë gjimnazet Këto shkolla janë të vendosura në zona qendrore dhe me akses më të gjerë, për të mbuluar një numër sa më të madh nxënësish nga të gjitha njësitë administrative të bashkisë.

<i>Njesia Administrative</i>	Emri i shkolles
<i>Laç</i>	Gjin Pjetri
	Gjon.Gjonaj
	Mark Trokthi
	Gjokë Elezi
	NR.3
	At' Shtjefën Gjeçovi
<i>Mamurras</i>	Migjeni
	Ismail Dema
	Arif Halil Sulaj
	F.P.Piroli
	Adem Myrta
	Demokracia
	Besnik Syla
	Don Bajrami
	Cub Çapani
	Vinjolle
	Shullaz
	Skuraj
<i>Milot</i>	Gjimnazi Milot
	28Nëntori
	Milot
<i>Fushë-Kuqe</i>	Fushe Kuqe
	Nikë Tomë Prela
	Adriatik
	At Shtjefën Kurti Gorre
	Nikoll Miri

- **Mamurras** ka numrin më të madh të shkollave (8), duke reflektuar një përqendrim më të lartë të popullsisë shkollore ose mbulim më të gjerë të zonave përreth.
- **Laç** dhe **Milot** kanë nga 6–7 shkolla secila, dhe përfaqësojnë njësitë me akses më të mirë gjeografik dhe infrastrukturor.
- **Fushë-Kuqe**, me vetëm 5 shkolla, është njësia më pak e mbuluar, gjë që mund të lidhet me dendësinë më të ulët të popullsisë ose sfida gjeografike në organizimin e shërbimit arsimor.

Analiza e nevojave për rikonstrukcion në institucionet arsimore

Në territorin e Bashkisë Kurbin, një pjesë e konsiderueshme paraqet nevoja të qarta për ndërhyrje infrastrukturore, sanitare, elektrike dhe të tjera specifike që lidhen me sigurinë, funksionalitetin dhe standardet e ofrimit të shërbimit arsimor.

Nevoja të përgjithshme të identifikuara

- **Rikonstrukcion i pjesshëm ose i plotë:** raportuar në disa shkolla si: *Adem Myrta, Adriatik*.
- **Ndërhyrje sanitare dhe hidraulike** në disa institucione, përfshirë *Gjin Pjetri, Gjon Gjonaj, Shullaz, Skuraj, Don Bajrami*.
- **Probleme kritike sigurie**, si në rastin e shkollës *Ismail Dema* në Mamurras, ku është theksuar se dera kryesore e ndërtesës është e dëmtuar dhe përbën rrezik për nxënësit dhe stafin.
- **Nevoja për përmirësime infrastrukturore të jashtme** – p.sh., në *Nikë Tomë Prela* kërkohet sinjalistikë rrugore dhe nivelim i hapësirës përpara hyrjes.
- **Ndërhyrje në rrjetet elektrike dhe sistemin e ngrohjes** si *F.P. Piroli, Skuraj* dhe *At' Shtjefën Gjeçovi*.

Frekuentimi në Arsimin fillor

Sipas të dhënave më të fundit nga INSTAT, në arsimin fillor janë të regjistruar gjithsej **1,882 nxënës**, nga të cilët **994 janë djem** (52.82%) dhe **888 vajza** (47.18%). Kjo shpërndarje gjinore pasqyron nivelin aktual të përfshirjes në këtë fazë të edukimit, e cila mund të ndryshojë ndjeshëm nga njësi në njësi në varësi të kushteve lokale, strukturës demografike dhe mundësive që ofron komuniteti.

Të dhënat nënvizojnë nevojën për të vazhduar përpjekjet në drejtim të garantimit të aksesit të barabartë dhe gjithëpërfshirës në arsimin fillor për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit apo karakteristikave të tjera sociale. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për ndjekjen e shkollës dhe mbështetja institucionale mbeten faktorë thelbësorë për përmirësimin e vazhdueshëm të përfshirjes në këtë cikël.

Frekuentimi në Arsimin 9-vjeçar

Në arsimin 9-vjeçar rezultojnë të regjistruar gjithsej **1,811 nxënës**, prej të cilëve **984 janë djem** (54.33%) dhe **827 janë vajza** (45.67%). Kjo ndarje tregon një pjesëmarrje disi më të lartë të djemve në këtë cikël, edhe pse variacionet gjinore mund të ndryshojnë në nivel njësisht administrative.

Situata e përfshirjes në arsimin bazë kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe zhvillimin e politikave mbështetëse që nxisin vazhdimësinë e shkollimit për të gjithë fëmijët. Garantimi i kushteve të favorshme mësimore dhe logjistike është thelbësor për të siguruar që çdo fëmijë të ketë mundësinë të përfundojë arsimin bazë në mënyrë të barabartë dhe dinjitoze.

Frekuentimi në Arsimin e mesëm

Në arsimin e mesëm janë të regjistruar gjithsej **1,302 nxënës**, nga të cilët **680 janë djem** (52.23%) dhe **622 janë vajza** (47.77%). Kjo shpërndarje reflekton prirjet e pjesëmarrjes në këtë cikël arsimor, ku vendimmarrja e familjes dhe vetë të rinjtë ndikohet nga faktorë si orientimi profesional, qasja ndaj shkollave, dhe kushtet socio-ekonomike.

Në këtë nivel arsimor, përfshirja e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse është veçanërisht e rëndësishme, duke qenë se arsimi i mesëm është një pikë kritike për orientimin e mëtejshëm drejt tregut të punës apo studimeve të larta. Prandaj, është e nevojshme që politikat arsimore të synojnë reduktimin e barrave sociale dhe ekonomike që ndikojnë në braktisjen shkollore dhe të mbështesin sa më shumë përfshirjen aktive të të rinjve në këtë cikël.

4. Shpërndarja e institucioneve arsimore në njësitë administrative të Bashkisë Kurbin

Njësia Administrative: Laç

Në njësinë administrative të Laçit funksionojnë gjithsej **6 shkolla**, të cilat janë të shpërndara në mënyrë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto institucione:

- **5 janë shkolla 9-vjeçare**, që ofrojnë ciklin e plotë të arsimit bazë;

Këto shkolla janë të pozicionuara në mënyrë që të sigurojnë akses të qëndrueshëm në arsim, si për banorët e zonave urbane, ashtu edhe për ata në periferi. Ato përfaqësojnë një hallkë të rëndësishme në përpjekjen për zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësim të nivelit të arsimit të fëmijëve.

Lista e shkollave në Laç:

- Shkolla “Gjin Pjetri”
- Shkolla “Gjon Gjonaj”
- Shkolla “Mark Trokthi”
- Shkolla “Gjokë Elezi”
- Shkolla NR.3
- Shkolla “At’ Shtjefën Gjeçovi”

Për fëmijët e moshës 3–6 vjeç, në Laç funksionojnë **4 kopshte publike**, të cilat janë të shpërndara në mënyrë që të garantojnë akses të barabartë për çdo familje. Këto institucione ofrojnë edukim të hershëm dhe mbështetje për përgatitjen për shkollë.

Lista e kopshteve në Laç:

- Kopshti “Gjokë Elezi”
- Kopshti nr. 1 Laç
- Kopshti nr. 2 Laç
- Kopshti nr. 3 Laç

Njësia Administrative: Mamurras

Në njësinë e Mamurrasit janë të hapura **8 shkolla**, të strukturuar si më poshtë:

- **6 shkolla 9-vjeçare**, që ofrojnë arsim të detyrueshëm bazë;
- **1 shkollë e mesme**;

Rrjeti i këtyre institucioneve garanton mbulim të gjerë për banorët e kësaj njësie, si në qendër, ashtu edhe në zonat më të largëta.

Lista e shkollave në Mamurras:

- Shkolla “Migjeni”
- Shkolla “Ismail Dema”
- Shkolla “Arif Halil Sulaj”
- Shkolla “F.P. Piroli”
- Shkolla “Adem Myrta”
- Shkolla “Demokracia”
- Shkolla “Besnik Syla”
- Shkolla “Don Bajrami”

Po ashtu, Mamurrasi ofron një rrjet të zhvilluar të edukimit parashkollor përmes **7 kopshteve publike**, duke përfshirë kopshte brenda shkollave dhe institucione të dedikuara.

Lista e kopshteve në Mamurras:

- Kopshti “Demokracia”
- Kopshti “Adem Myrta”
- Kopshti “Ismail Dema”
- Kopshti “Dan Bajrami”
- Kopshti “Fran Pal Piroli”
- Kopshti “Mimozat”
- Kopshti nr. 2 Mamurras

Njësia Administrative: Milot

Në njësinë e Milotit funksionojnë gjithsej **7 shkolla**, nga të cilat:

- **6 janë shkolla 9-vjeçare**;
- **1 është shkollë e mesme**;

Këto shkolla janë të shpërndara në zonat qendrore dhe përreth, duke siguruar vazhdimësi në arsim për nxënësit e ciklit bazë dhe atij të mesëm të lartë.

Lista e shkollave në Milot:

- Shkolla “Cub Çapani”
- Shkolla Vinjolle
- Shkolla Shullaz
- Shkolla Skuraj
- Gjimnazi Milot
- Shkolla “28 Nëntori”
- Shkolla Milot

Rrjeti i edukimit parashkollor në Milot përbëhet nga **6 kopshte**, të cilat ofrojnë mbështetje për zhvillimin e hershëm të fëmijëve.

Lista e kopshteve në Milot:

- Kopshti Milot
- Kopshti “28 Nëntori”
- Kopshti Shullaz
- Kopshti “Cub Çapani”
- Kopshti Skurraj
- Kopshti Vinjollë

Njësia Administrative: Fushë-Kuqe

Në Fushë-Kuqe janë të hapura **5 shkolla**, të strukturuar si më poshtë:

- **4 shkolla 9-vjeçare;**
- **1 shkollë e mesme;**

Kjo strukturë shërben për të përmbushur nevojat arsimore të zonës dhe për të garantuar përfshirjen në arsim për fëmijët e komunitetit lokal.

Lista e shkollave në Fushë-Kuqe:

- Shkolla Fushë Kuqe
- Shkolla “Nikë Tomë Prela”
- Shkolla “Adriatik”
- Shkolla “At Shtjefën Kurti Gorre”
- Shkolla “Nikoll Miri”

Në funksion të edukimit të hershëm, në këtë njësi operojnë **4 kopshte**, të vendosura në pika kyçe për të mbuluar sa më shumë komunitete.

Lista e kopshteve në Fushë-Kuqe:

- Kopshti “Nikë Tomë Prela”
- Kopshti “Adriatik”
- Kopshti “Nikoll Miri”
- Kopshti Fushë Kuqe

5. Analiza edhe shperndarja e stafit arsimor në territorin e bashkisë

Shërbimet e arsimit parashkollor në Bashkinë Kurbin janë të mbështetura nga një rrjet i dedikuar i edukatoreve dhe stafit ndihmës, që sigurojnë një mjedis të kujdesshëm dhe të mbrojtur për zhvillimin e hershëm të fëmijëve. Të dhënat tregojnë një përkushtim të vazhdueshëm të bashkisë për të garantuar staf të mjaftueshëm dhe mbikëqyrje të qëndrueshme në institucionet e edukimit të hershëm.

1. Stafi edukativ dhe ndihmës

Në total, në të gjitha njësitë administrative funksionojnë:

- **75 edukatore**, që sigurojnë përkujdesje dhe edukim të përshtatur për fëmijët e moshës 3–6 vjeç;
- **22 punonjës sanitarë**, që garantojnë standarde të mira higjieno-sanitare në ambiente të brendshme dhe të jashtme të kopshteve.

Kjo përfaqëson një nivel të mirë mbulimi të nevojave bazë për shërbim dhe kujdes, sidomos në një territor me shpërndarje të gjerë të njësive administrative. Rrjeti i edukatoreve është funksional në çdo institucion dhe garanton vazhdimësi në përkujdesjen e fëmijëve.

2. Mbështetja psiko-sociale

Një praktikë pozitive që vihet re në Bashkinë Kurbin është **bashkëpunimi i kopshteve me psikologët e shkollave**, të cilët kontribuojnë në mirëqenien emocionale dhe zhvillimin social të fëmijëve në moshë të hershme. Kjo formë integrimi ndërinstitutional është një model që mund të zhvillohet më tej në të ardhmen për të ofruar shërbime të dedikuara në çdo institucion.

Veçanërisht në njësinë e **Milotit**, të gjitha kopshtet kanë lidhje të rregullta me psikologun e shkollës përkatëse, çka është një hap inkurajues drejt institucionalizimit të përkrahjes psiko-sociale.

3. Masat e sigurisë dhe mbikëqyrja

Shumica e kopshteve janë të pajisura me **kamera sigurie**, të cilat kontribuojnë në monitorimin e ambienteve dhe mbrojtjen e fëmijëve. Ky është një hap pozitiv në drejtim të sigurimit të mjediseve të sigurta për mësim dhe lojë.

Kjo panoramë tregon për përkushtim serioz të Bashkisë Kurbin në garantimin e një edukimi të hershëm cilësor, gjithëpërfshirës dhe të sigurt për të gjithë fëmijët. Hapat e ndërmarra deri më sot krijojnë një bazë të qëndrueshme për avancimin e mëtejshëm të shërbimeve parashkollore në përputhje me standardet më të mira bashkëkohore

6. Vizioni, qëllimet strategjike, objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar

Vizioni

“Bashkia Kurbin synon të zhvillojë një sistem arsimor parauniversitar të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe cilësor, të ndërtuar mbi identitetin dhe potencialin lokal të territorit – nga zona urbane me histori industriale, deri në komunitetet rurale me tradita të forta bashkëpunimi. Nëpërmjet rritjes së aksesit, përmirësimit të infrastrukturës dhe forcimit të shërbimeve mbështetëse, synohet të garantohen mundësi të barabarta për çdo fëmijë dhe të ri për të mësuar, për t’u zhvilluar dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në jetën e komunitetit.”

Prioritetet zhvillimore që udhëheqin vizionin:

- 1. Zgjerimi dhepërmirësimi i infrastrukturës arsimore**
 - Mirëmbajtje dhe rikonstruksion i godinave të shkollave dhe kopshteve me prioritetizim të sigurisë, aksesit dhe kushteve mësimore.
- 2. Garancia për akses dhe përfshirje të barabartë**
 - Përfshirje e plotë e fëmijëve 3–6 vjeç në edukimin parashkollor, me fokus në grupet në nevojë.
 - Mbështetje për ndjekjen e arsimit bazë dhe të mesëm në zona rurale dhe të largëta.
- 3. Rritja e cilësisë në mësimdhënie dhe shërbime mbështetëse**
 - Trajnime për edukatorët dhe mësuesit për metoda bashkëkohore dhe zhvillim gjithëpërfshirës.
 - Forcimi i shërbimeve psiko-sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve brenda institucioneve arsimore.
- 4. Digjitalizimi dhe teknologjia në funksion të mësimi dhe menaxhimit.**
 - Regjistra elektronik të menaxhimit dhe monitorimit të të dhënave dhe treguesve për performancën arsimore dhe mirëqenien e nxënësve.
- 5. Arsimit që lidhet me komunitetin dhe përgatit për të ardhmen**
 - Fuqizimi i bashkëpunimit shkollë–familje–komunitet.
 - Zhvillimi i shkollave si qendra komunitare që nxisin vlera qytetare, kulturë dhe kujdes ndaj mjedisit.

Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve

Qëllimi 1: Përmirësimi i infrastrukturës arsimore dhe kushteve bazë për një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe nxitës për të nxënë në shkolla dhe kopshte

Objektivat specifike:

- **Objektivi 1.1:** Sigurimi i funksionimit të përditshëm dhe të pandërprerë të institucioneve arsimore përmes garantimit të stafit të kualifikuar (arsimor dhe ndihmës), dhe përmirësimit të shërbimeve bazë si: uji, energjia, ngrohja, higjiena, ushqimi në kopshte, transporti për zonat e largëta dhe furnizimi me materiale të nevojshme.
- **Objektivi 1.2:** Realizimi i ndërhyrjeve infrastrukturore dhe rikonstruksioneve në shkollat dhe kopshtet ekzistuese, duke adresuar problemet prioritare (sanitare, elektrike, siguri konstruktive), si dhe pajisja e tyre me mjete didaktike dhe teknologji moderne në përputhje me zhvillimet bashkëkohore.

Qëllimi 2: Rritja e cilësisë dhe përfshirjes në arsimin parashkollor dhe atë bazë në të gjithë territorin e bashkisë

Objektivat specifike:

- **Objektivi 2.1:** Përmirësimi i cilësisë së edukimit përmes zhvillimit profesional të edukatorëve dhe mësuesve, përditësimit të përmbajtjes mësimore dhe sigurimit të metodologjive gjithëpërfshirëse në procesin mësimor.
- **Objektivi 2.2:** Zgjerimi i shërbimeve mbështetëse për fëmijët me aftësi ndryshe dhe nevoja të veçanta përmes punësimit të mësuesve ndihmës dhe fuqizimit të shërbimit psiko-social në bashkëpunim me shkollat.
- **Objektivi 2.3:** Ngritja dhe funksionalizimi i strukturave të bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet (borde, këshilla prindërishe, komisione mirëqenieje), për të përmirësuar pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen kolektive.

Qëllimi 3: Edukimi i plotë dhe i balancuar i fëmijëve dhe të rinjve përmes zhvillimit kulturor, social dhe emocional me përfshirjen e komunitetit

Objektivat specifike:

- **Objektivi 3.1:** Integrimi i aktiviteteve jashtëkurrikulare në jetën e përditshme të shkollave dhe kopshteve, përmes organizimit të aktiviteteve edukative, artistike, kulturore dhe sportive që nxisin aftësitë sociale dhe emocionale të fëmijëve.

7. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parauniversitar

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

